

# Buletin informativ

**Korrik 2020**



Eskpertët fiskal në Mazars kanë përgatitur buletin informativ të rradhës, si një përmbledhje e projektligjit “Mbi amnistinë fiskale dhe penale për subjektet që bëjnë deklarim vullnetar të pasurive”, (këtu më poshtë referuar si “Projektligji”).

Projektligji është aktualisht në fazën e diskutimit publik, ndërkohë ende nuk janë publikuar aktet normative në zbatim të tij.

## **Kush është qëllimi i Projektligjit?**

Projektligji ka për qëllim formalizimin e të ardhurave të krijuara nga puna informale, si dhe formalizimin e fitimeve të padeklaruara në vite të entiteteve ligjore. Formalizimi do të kryhet duke paguar një normë tatimore të posaçme brenda afateve të përcaktuara ligjore.

Subjektet përfituese, ndaj të cilëve lëshohet vërtetimi përkatës i përfundimit të procesit të deklarimit vullnetar, përjashtohen nga ndjekja penale për veprat që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me krijimin dhe disponimin e të ardhurave/ pasurive të deklaruara sipas kushteve të përcaktuar në këtë Projektligj.

## **Kush janë subjektet që përfitojnë nga kjo amnisti?**

Subjektet që përfitojnë nga kjo amnisti janë:

# Buletin informativ

- Individët shtetas të Republikës së Shqipërisë pavarësisht nëse janë rezident tatimor ose jo në Republikën e Shqipërisë;
- Personat fizik dhe juridik, tatimpagues rezident në Republikën e Shqipërisë;
- Individët rezident tatimor në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht shtetësisë së tyre.

## **Kush janë subjektet që përjashtohen nga e drejta për të përfituar nga amnistia?**

Janë subjekte të përjashtuara nga e drejta e përfitimit nga amnistia:

- Nënpunësit civilë që kanë detyrimin ligjor për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjeve përkatëse;
- Individët të cilët kanë qenë mbajtës të detyrave apo funksioneve të larta publike në datën e hyrjes në fuqi të këtij Projektligji;
- Individët/subjektet, të ardhurat e të cilëve janë me prejardhje kriminale apo nga organizatat terroriste.

## **Cili është institucioni përgjegjës për zbatimin e kësaj amnistie?**

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve do të ngrihet një strukturë e posaçme, e quajtur “Njësia Speciale” e cila do të mbikqyrë deklarimin vullnetar të pasurive nga ana e subjekteve, si dhe do të lëshojë në përfundim të procesit vërtetimin për kryerjen e tij.

## **Cilat janë procedurat për t’u ndjekur?**

### **1. Deklarimi vullnetar për individët**

Të gjithë individët përfitues të kësaj amnistie mund të deklarojnë vullnetarisht të ardhurat dhe pasuritë e tyre duke ndjekur hapat e mëposhtme:

**Hapi 1.** Individ i ose përfaqësuesi i tij plotëson formularin e deklarimit vullnetar (të shumës në të holla ose pasurive të tjera të regjistrueshme) pranë Njesisë Speciale;

**Hapi 2.** Formulari i deklarimit vullnetar verifikohet për mënyrën e plotësimit të tij nga njësia në fjalë dhe individ i pajiset me kopje të aplikimit;

**Hapi 3.** Aplikuesi apo përfaqësuesi i tij duhet të:

(i) në rast deklarimi të të ardhurave monetare- depozitohet shumat në të holla në llogarinë përkatëse bankare; ose

# Buletin informativ

(ii) në rast deklarimi të pasurive të tjera- kryejë regjistrimin e tyre në përputhje me parashikimet ligjore të fushës.

**Hapi 4.** Individu ose përfaqësuesi i tij paguan shumën e tatimit të posaçëm në përputhje me parashikimet e këtij Projektligji.

Në përfundim të procesit, brenda 20 ditësh nga dorëzimi i dokumentacionit, subjekti deklarues pajiset me vërtetim për përfundimin e procesit të deklarimit vullnetar.

***Kujdes:*** Pajisja me vërtetimin për deklarimin e pasurisë nuk do të thotë regjistrim i tyre pranë zyrave përkatëse të pasurisë.

## 2. Deklarimi vullnetar për personat juridik

Personat juridik mund të rideklojnë elementë të veçantë të aktiveve, detyrimeve apo kapitaleve të veta, me synimin për të siguruar një paraqitje reale, të vërtetë dhe të drejtë të tyre në pasqyrat financiare.

Çdo diferencë midis gjendjes reale të elementëve të pasqyrave financiare me gjendjen aktuale kontabël, e cila jep efekt në rritjen e të ardhurave apo në kapital do të jetë subjekt i tatimit të posaçëm, Këto diferenca nuk do të konsiderohen për qëllime tatimore, duke krijuar kështu të ardhura të patatueshme apo shpenzime të pazbritshme.

Procedurat e deklarimit vullnetar për personat juridik janë të njëjta me ato të parashikuara për personat fizik. Me Udhëzim të Ministrit të Financave do të përcaktohet përmbajtja e formularëve të deklarimit.

### Cilat janë normat e tatimit të posaçëm?

Mbi të ardhurat/pasuritë e deklaruara do të aplikohen normat e mëposhtme tatimore:

- 5 % të vlerës të deklaruar për deklarime dhe pagesa të kryera në katër muajt e parë nga hyrja në fuqi e ligjit;
- 7 % të vlerës të deklaruar për deklarime dhe pagesa të kryera në katër muajt e dytë nga hyrja në fuqi e ligjit;
- 10 % të vlerës të deklaruar për deklarime dhe pagesa të kryera në katër muajt e tretë nga hyrja në fuqi e ligjit.

# Buletin informativ

## Cilat janë përfitimet e deklarimit vullnetar?

Subjektet deklaruese kanë këto përfitime për të ardhurat/pasuritë e deklaruara në përputhje me Projektligjin:

- Detyrimet tatimore të lidhura me to konsiderohen si të paguara në përputhje me legjislacionin shqiptar;
- Përfshihen nga detyrimi i dhënies së informacionit në lidhje me kohën, mënyrën e krijimit, mbajtjen apo posedimin e tyre;
- Përfshihen nga ndjekja e procedurave hetimore dhe administrative në lidhje me krijimin e tyre;
- Përfshihen nga ndjekja dhe procedimi penal;
- Mosvënia e masës së sekuestros apo konfiskimit ndaj pasurive të deklaruara vullnetarisht;
- Falja e gjobave/ kamatvonesave/ penalteteve për deklarimet me vonesë të tyre.

***Shënim:*** Përmbledhja e mësipërme bazohet në parashikimet e projektligjit “Mbi amnistinë fiskale dhe penale për subjektet që bëjnë deklarim vullnetar të pasurive” i cili është momentalisht në proces konsultimit publik dhe mund të jetë subjekt ndryshimi. Në rast ndryshimesh, Mazars do t’ju njoftojë nëpërmjet publikimeve të rradhës.

# Buletin informativ

## KONTAKT

### MAZARS ALBANIA & KOSOVO

Për më shumë detaje për çështjet e mësipërme apo të tjera në lëmin fiskal, ju lutem drejtohuni:

#### Teit GJINI

Managing Partner  
teit.gjini@mazars.al

#### Erinda XHAFERRAJ

Head of Tax Advisory Services  
erinda.xhaferraj@mazars.al

#### Adresa

Rr. Emin Duraku, Pall. Binjaket, Nr.5,  
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2222 889  
E-mail: [info@mazars.al](mailto:info@mazars.al)